



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 687/1 prot.

Tiranë, më 3.7.2025

VENDIM
Nr.30, datë 3.7.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 40, DATË 26.06.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 40, datë 26.06.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*.

KONSTATOVA SE:

Komisioneri, me urdhrin nr. 43, datë 21.03.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmejt pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Gramsh”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Gramsh.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 40, datë 26.06.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*, të Komisionerit, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 131, datë 20.12.2024, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 40, datë 26.06.2024, të Komisionerit”*, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr.40, datë 26.06.2024, në institucionin Bashkia Gramsh, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 953/1, datë 20.12.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Gramsh me shkresën nr. 953/2, datë 20.12.2024, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr.40, datë 26.04.2024 të Komisionerit”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Në vijim, me urdhrin nr. 51, datë 18.06.2025, *“Për zhvillimin e seancave dëgjimore në kuadër të masave për zbatimin e vendimeve paralajmëruese”*, të Komisionerit, njoftuar Bashkisë Gramsh me shkresën nr.626/3 Prot., datë 18.06.2025, Komisioneri ka urdhëruar, ndër të tjera, zhvillimin e një seance dëgjimore në datën **23.06.2025, ora 10:30**, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtij subjekti, me qëllim vlerësimin e masave të marra për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 40, datë 26.06.2024.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 40, datë 26.06.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt dhe gjatë seancës dëgjimore, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, nëse është riorganizuar plani i rekrutimit për vitin 2024, duke përfshirë pozicionet efektivisht të lira, por edhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin dhe a janë zhvilluar rekrutime në grup për pozicionet për të cilat lloji i diplomës dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta.

Konstatoj se, me vendimin nr. 9, datë 28.2.2024, *“Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2024”*, është miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2024, ndryshuar me vendimin nr.62, datë 10.10.2024 dhe vendimin nr. 84, datë 05.12.2024, *“Për një ndryshim në vendimin nr. 9, datë 28.02.2024”*, *Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2024*, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar procedurat e konkurrimit për 25 pozicione të lira të ndara sipas kategorive:

- 1 pozicion i nivelit të lartë drejtues (Sekretar i Përgjithshëm);
- 4 pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues (Drejtor drejtorie);
- 9 pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës sektori);
- 11 pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv (Specialistë).

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar me institucionin, u administrua edhe Vendimi nr. 24, datë 24.02.2025, *“Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2025”*, me anë të të cilit është miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për vitin 2025, ku është parashikuar zhvillimi i procedurave të rekrutimit për 23 pozicione të lira të shërbimit civil, të ndara sipas kategorive më poshtë:

- 2 pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues (Drejtor drejtorie);
- 10 pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës sektori);
- 11 pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv (Specialistë).

Në bazë të përcaktimeve të pikës 13, të VKM nr. 108, datë 26.2.2014, vendimi për miratimin e planit vjetor të punësimit, është publikuar në portalin *“Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”*, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 19 punonjësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të punës, në Bashkinë Gramsh vërej se për punonjësit më poshtë janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me institucionin. Konkretisht:

- Punonjësi Bledar Zani, në pozicionin *“Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore”*, është liruar nga detyra me urdhrin nr. 234, datë 28.06.2024;
- Punonjësja Zamira Kullolli në pozicionin *“Specialist i mbrojtjes sociale”* është liruar nga detyra me urdhrin nr. 345, datë 09.10.2024;
- Punonjësi Kristi Latifi në pozicionin *“Specialist për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”* është liruar nga detyra me urdhrin nr. 263, datë 22.07.2024.

Nga aktet e administruara (shpalljet e vendeve vakante nr. 1586 prot, nr. 1587 prot, dhe nr. 1588 prot, datë 15.04.2024; nr. 4504 prot., nr.1502 prot., dhe nr. 4507 prot., datë 15.10.2024; nr.3147 prot., dhe nr.3146 prot., datë 22.07.2024; nr. 4689 prot., dhe 4690 prot., datë 25.10.2024, dërguar Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë), konstatoj se, njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Gramsh ka realizuar 10 procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve vakante, si më poshtë:

- 3 pozicione *“Drejtor Drejtorie”* - *“Drejtor i Financës dhe Buxhetit”*, *“Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”* dhe *“Drejtor Juridik dhe Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit”*;
- 2 pozicione *“Përgjegjës Sektori”* - *“Përgjegjës i Emergjencave Civile dhe Strehimit”* dhe *“Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti”*; dhe
- 5 pozicione *“Specialist”* - *“Specialist për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, Hartim Projektesh”*, *“Specialist për Turizmin”*, *“Specialisti Auditit të*

Brendshëm”, “Specialist për Njësinë Administrative Kushovë” dhe “Specialist i Tatim- Taksave”.

Në përfundim të procesit kanë rezultuar fitues dhe janë emëruar punonjësit si më poshtë:

1. Ermal Hysa, me aktin nr. 2278 prot., datë 31.05.2024, është emëruar në pozicionin *“Drejtor”*, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit;
2. Orgent Çoniku, me aktin nr.2279 prot., datë 31.05.2024, është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
3. Edison Shahini, me aktin nr. 2277 prot., datë 31.05.2024. është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* në Drejtorinë Juridike dhe dhe Burimeve Njerëzore.
4. Amarildo Karaj, me aktin nr. 62 prot., datë 16.12.2024, është emëruar në pozicionin *“Specialist për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, Hartim Projektesh”*;
5. Andit Cani me aktin nr. 452 prot., datë 02.12.2024 është emëruar në pozicionin *“Specialist për Rininë, Turizmin dhe BE-në”*;
6. Aljeta Bora, me aktin nr. 520 prot., datë 06.02.2025, është emëruar në pozicionin *“Specialisti Auditit të Brendshëm”*;
7. Anisa Ymeri, me aktin nr. 5451 prot., datë 02.12.2024, është emëruar në pozicionin, *“Specialist për Njësinë Administrative Kushovë”*;
8. Sofjeta Topalli, me aktin nr. 3797 prot, datë 04.09.2024 është emëruar në pozicionin, *“Specialist i Tatim Taksave”*.
9. Ejona Blloshmi, me aktin nr. 5660 prot., datë 16.12.2024, është emëruar në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të emergjencave Civile dhe Strehimit”*;
10. Juljana Taçe, me aktin nr.5661 prot. datë 16.12.2024 është emëruar në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti”*,

Ndërkohë, nga aktet e administruara gjatë seancës dëgjimore rezulton se, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Gramsh ka shpallur procedurat për rekrutim në shërbimin civil për pozicionet e mëposhtme:

1. *“Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar”*, me shkresën nr. 2374 prot., datë 19.6.2025;
2. *“Specialist për Performancën, Statistika dhe Koordinator për të Drejtën e Informimit”*, me shkresën nr. 2375 prot., datë 19.6.2025;
3. *“Përgjegjës i Sektorit të Arkivës”*, me shkresën nr. 2376 prot., datë 19.6.2025;
4. *“Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”*, me shkresën nr. 2377 prot., datë 19.6.2025;
5. *“Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore”*, me shkresën nr. 2378 prot., datë 19.6.2025.

Njëkohësisht, me urdhrin nr. 187, datë 20.06.2025, vërej se është bërë ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësin Mario Bici, në pozicionin, *“Drejtor i Emergjencave Civile, Strehimit dhe Koordinimit me Njësitë Administrative”*, dhe me urdhrin nr. 188, datë 20.06.2025, është bërë ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil

për punonjës in Floren Baku në pozicionin, “Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave Familjare në Njësitë Administrative”, duke i kaluar këto pozicione jashtë shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, vlerësoj se, nga ana e institucionit, Bashkia Gramsh, janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.40, datë 26.06.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 (i ndryshuar), të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 40, datë 26.06.2024, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gramsh dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Gramsh duke zbatuar detyrat e lëna të dispozitivit të Vendimit nr.40, datë 26.06.2024.
3. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Gramsh.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha